

Shkolla Shqipe "Dardania" Tiel

- **Organizimi i mësimit plotësues në gjuhën shqipe do të zhvillohet në bazë të:**
 - Kurikules së shkollës shqipe të mësimit plotësues në diasporë (**MASHT, 2007**)
 - Shkëmbimit të përvojave me shkollat shqipe në diasporë
 - Si dhe mënyres së organizimit të mësimit të gjuhës Holandeze për të huaj nga CVO.
 - Procesi mësimor përmban tri nivele
 - Secili nivel është i ndarë në 4 module
 - Një modul do të zgjasë 45 orë mësimi (15 x 3)
 - Një vit shkollor përmban dy module
 - Moduli I parë fillon në javën e dytë të muajit shtator dhe përfundon në dhjetor
 - Moduli I dytë fillon në muajin janar dhe përfundon në muajin maj
 - Mësimi do të zhvillohet të dielën prej orës 13:00 deri në orën 16:00 (3 orë mësimi)
 - Me kërkesën e prindërve do të shqyrtojmë mundësin që mësimi të zhvillohet edhe të mërkurën
 - Në bazë të moshës ndarja e nxënësve do të bëhet në tri grupe:
 - Grupi i parë moshë 7 deri 9 vjet
 - Grupi i dytë moshë 10 deri 12 vjet
 - Grupi i tretë moshë 13 deri 15 vjet

Objektivat janë *:

- Aftësimi i nxënësve të komunikojnë në gjuhën shqipe në kontekste të ndryshme, përmes bisedës, shkrimit dhe leximit
- Të njohin, të kuptojnë dhe të çmojnë traditën, vlerat dhe të arriturat kombëtare
- Të njohin, të kuptojnë dhe të analizojnë në mënyrë kritike zhvillimet më të rëndësishme të historisë së kombit shqiptar, si pjesë e historisë së përgjithshme të njerëzimit

**Këto objektiva janë marrë nga Kurikula e Shkollës Shqipe të Mësimit Plotësues në diasporë*